



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.48, datë 12.04.2024

**PËR**

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN MEDIANA META”**

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Mediana Meta, si pedagog me kohë të pjesshme në lëndën “E drejta penale, Pjesa e Posaçme” në Universitetin Aleksandër Moisiu, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, për 20 (njëzet) orë në semestrin e dytë.
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Mediana Meta, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 12.04.2024.

**ZV/KRYETAR**

**Tartar Bazaj**

